

PËR NJË RTK TË REDUKTUAR

Qëllimi i një transmetuesi publik është që t'i shërbejë nevojave dhe të mirës publike. Për ta përmbushur mandatin e tij, është e nevojshme që të garantohet pavarësia e transmetuesit publik, përmes udhëheqjes pluraliste dhe të paanshme. Duhet të sigurohet financimi transparent i cili garanton se informacioni do të transmetohet lirshëm, në mënyrë të pavarur dhe që i kontribuon ideve të reja. Poashtu, është qenësore që transmetuesit publik të japin llogari direkte ndaj qytetarëve, sidomos në raport me kryerjen e detyrës sipas misionit të përcaktuar dhe përdorimin e resurseve publike.

Kjo është, pak a shumë, ajo që më së shpeshti dëgjohej kur të diskutohet RTK-ja në Kosovë. Ose të paktën kjo dëshirohet të thuhet nga ata që diskutojnë. Aktualisht, në vendin tonë, situata në këtë fushë, jobefasisht, lë shumë për të dëshiruar në të gjitha nivelet.

Por, si rëndom në diskutimet publike tek ne, më shumë merremi me pasojat sesa me shkakun. Në këtë rast, shkakun është ekzistenca e Radio Televizionit të Kosovës (RTK) në përmasat aktuale, kurse pasoja është politika redaktuese, kualiteti i programeve apo profesionalizmi i punëtorëve të RTK-së, ose edhe kontratat e përfolura si të dëmshme për RTK-në dhe taksapaguesit.

Prandaj, ne duhet ta shtrojmë një pyetje edhe më fundamentale: a duhet të ekzistojë RTK-ja dhe nëse po, çfarë RTK-je na duhet?

Nuk ka dyshim se shoqërisë sonë demokratike i nevojitet televizioni dhe radioja publike të cilat e bëjnë transmetimin direkt të seancave parlamentare (kur ato janë të hapura për publikun), të mbledhjeve të komisioneve dhe mbledhjeve të Qeverisë, si dhe të konferencave eventuale për shtyp menjëherë pas atyre seancave apo mbledhjeve. Kjo garanton që qytetarët të mund të jenë të informuar për të marrë vendime të informuara.

Më tej, na nevojitet mediumi publik i cili transmeton direkt mesazhet e kreut të shtetit ose të Qeverisë kur ata i drejtohen qytetarëve, në raste të festash dhe (sidomos) në raste të jashtëzakonshme. Nevojitet, poashtu, që të emetohet i tërë ai material në të gjitha gjuhët zyrtare të shtetit. Transmetimi i materialit duhet të bëhet edhe nëpërmjet internetit.

Me kaq, me përjashtime të vogla, përfundon ajo që *nevojitet patjetër, pra detyrat esenciale*, që do të duhej t'i kryejë një transmetues i cili funksionon me paratë tuaja, me paratë tona, pra me paratë e takspaguesve.

Por, më shumë se kaq, për asnjë detyrë tjetër transmetuesi publik nuk është i pazëvendësueshëm.

Para se të vazhdojmë më tutje, të theksojmë se është bërë zakon që kurdo që të diskutohet RTK-ja, ose cilido medium tjetër, ka rrezik që të ketë akuza, herë me vend e shpesh pa vend, për sulm të gazetarisë së pavarur. Njëkohësisht, jo rrallë ndodh që ata që kritikojnë janë vetë fajtorë për ndikim politik, nëse jo në ndonjë medium, të paktën në plot institucione ku iu shkon fjala ose vepra.

Ne këtu nuk ndalemi në sulme e kundërsulme, kritika të mirëfillta apo njollosëse, të mediave dhe ndaj mediave në Kosovë. Sidoqoftë, nuk mund të mos e përmendim se në një diskutim të përgjithshëm të mediave tek ne duhet të merren parasysh një sërë faktorësh, përfshirë presionin e pushtetarëve (në të gjitha format: disa nene të Kodit Penal, prezenca ose jo e reklamave të kompanive publike, etj.), por edhe ndërhyrjet e pronarëve (për të imponuar politikë joparimore redaktuese, për mosrespektim të ligjit të punës, mospagesë të tatimit, korrupsion, etj.).

Për tu kthyer tek RTK-ja, patjetër se ka disa programe që na pëlqejnë në RTK e ndoshta plot të tilla nuk na pëlqejnë. Ndoshta ka redaktorë përgjegjës të përgjegjshëm e ndoshta ka të tillë të papërgjegjshëm. Por, pyetja që shtrohet sot është: me gjithë respektin, a ia vlen përgjegjësia apo papërgjegjësia e dikujt në RTK më shumë se 8 milion euro në vit? Kjo është shuma, përafërsisht, që ne, qytetarët e Kosovës, e paguajmë për RTK-në.

Edhe sikur RTK-ja të kishte program shumë më të pasur, profesional e të pavarur, nuk ka arsye të ekzistojë si institucion publik në formën e tashme. Nëse ofron program kualitativ si televizion privat, jam i sigurtë që do t'i mbijetonte konkurrencës së tregut, përndryshe, nuk ka arsye që RTK-ja të ekzistojë. Prandaj, RTK-ja duhet të ristrukturohet dhe në masë të madhe të reduktohet.

Edhe nën një udhëheqje tjetër qeveritare do të kishte përherë anime politike, sado të vogla, të politikës redaktuese të një transmetuesi publik. Por, siç pyesin shpesh qytetarët me të cilët kam biseduar, pse u deshka që ne t'i paguajmë me paratë tona animet politike të dikujt?

Në RTK ka punëtorë të devotshëm, të cilët e gëzojnë respektin tonë dhe ne duhet ta përkrahim punën e tyre profesionale e të paanshme deri në një zgjidhje finale të problemit të RTK-së. Por, për t'i ndihmuar gazetarisë në Kosovë, demokracisë në Kosovë, informacionit të lirë në Kosovë dhe përgjegjësisë me paratë e qytetarëve të Kosovës, duhet të ndërmarim masa më largpamëse që RTK-ja t'i kryejë vetëm detyrat esenciale të përshkuara më sipër.

Disa mund ta kundërshtojnë këtë ide me argumentin qëllimisht prekës, por jo logjik, se familjet që “mbahen” nga pagat e RTK-së do të mbesin keq. Por, të tilla argumente i harrojnë familjet e paprivileguara të atyre që mbesin keq pikërisht për shkak të të hollave të shpenzuara pa nevojë në RTK.

Një debat mbi (mos)nevojën e ekzistencës së transmetuesit publik, në një kontekst tjetër, po zhvillohet edhe në Portugali, për shkak të shtrëngimeve bugjetore atje. Në rastin tonë argumentet e mësipërme e marrin një peshë më të madhe, jo vetëm për shkak të situatës ekonomike jo të mirë të vendit në përgjithësi, por edhe për shkak të ndërhyrjeve në RTK si dhe për shkak të nivelit jombresëlënës të gazetarisë profesioniste në vend pikërisht pikërisht për shkak të këtyre ndërhyrjeve.

Tash jetojmë në dekadën e dytë të shekullit 21. Jetojmë në një kohë digjitale. Dikur kishte gazetë ditore “publike” ose shtetërore – tash nuk ka ma të tillë. Sot ka radio e televizion publik – e tash ka ardhur koha që të mos ketë diçka të tillë.

Nuk ka nevojitet diktati i informatave të “shërbyera nga shteti”, edhe nëse shteti ynë do të avancojë shpejt për kah demokracia. Le ta përkrahim lirinë e medias, por njëkohësisht edhe lirinë nga shpenzimi i panevojshëm i parave të qytetarëve.